REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT

AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE KUALIFIKIMEVE

PROCESI I VETËVLERËSIMIT TË OFRUESVE PUBLIKË DHE JO PUBLIKË TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL

RAPORT KOMBËTAR PËR PROCESIN DHE REZULTATET

PERIUDHA E VETËVLERËSIMIT

2024-2025

SHKURTIMET

AFP	Arsim dhe Formim Profesional
IoAFP	Institucion ofrues i Arsimit dhe Formimit Profesional
SD4E	Programi i Zhvillimit të Aftësive për Punësim
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
MEI	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit
AKAFPK	Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
AKPA	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
QFP	Qendër e Formimit Profesional
SKPA	Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
KSHK	Korniza Shqiptare e Kualifikimeve
NJZH	Njësia e Zhvillimit
PEI	Plane Edukative Individuale
OSHC	Organiata të Shoqërisë Civile
VNJI	Validimi i të nxënit joformal dhe informal
TNGJGJJ	Të nxënit gjatë të gjithë jetës

PËRMBLEDHJE

Procesi i vetëvlerësimit për periudhën 2024–2025 u zhvillua në zbatim të Udhëzimit nr. 1, datë 10.2.2026, të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, "Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 16, datë 8.5.2018, 'Për zhvillimin e vetëvlerësimit në institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional'". Në përputhje me këtë kuadër rregullator, ofruesit publikë dhe jopublikë të Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP) zhvilluan procesin e vetëvlerësimit sipas kalendarit të hartuar dhe miratuar nga AKAFPK, duke mbledhur të dhënat përkatëse dhe hartuar raportet përfundimtare të vetëvlerësimit.

Pas përfundimit të procesit, u grumbulluan raportet e vetëvlerësimit të të gjithë ofruesve të AFP-së. Këto raporte u analizuan nga Sektori i Akreditimit të Ofruesve të AFP-së gjatë periudhës maj–korrik 2026, me qëllim hartimin e raportit kombëtar mbi procesin dhe rezultatet e vetëvlerësimit.

Përveç paraqitjes së rezultateve të vetëvlerësimit, raporti ofron një përmbledhje të zhvillimit historik dhe kuadrit rregullator të sigurimit të cilësisë në sistemin shqiptar të AFP-së, duke evidentuar institucionet përgjegjëse dhe rolin e tyre në këtë proces.

Raporti përshkruan gjithashtu metodologjinë e ndjekur për zhvillimin e vetëvlerësimit, kalendarin e zbatimit për periudhën 2024–2025, si dhe paraqet rezultatet për secilën prej pesë fushave të cilësisë, të mbështetura në analizën sasiore dhe cilësore të të dhënave të mbledhura dhe të raporteve të dorëzuara nga ofruesit.

Në përfundim, raporti paraqet rekomandime konkrete, të mbështetura në rezultatet e analizës, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së ofrimit të arsimit dhe formimit profesional.

KONTEKSTI HISTORIK

Sistemi i Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP) në Shqipëri mbështetet kryesisht në shkollat profesionale dhe qendrat e formimit profesional. Në kuadër të zhvillimit të këtij sistemi, AKAFPK ka ndërtuar dhe konsoliduar një cikël koherent politikash dhe procesesh të brendshme për zhvillimin, administrimin dhe garantimin e cilësisë së kualifikimeve profesionale, duke forcuar lidhjen e tyre me nevojat e tregut të punës.

Gjatë viteve të fundit janë ndërmarrë një sërë reformash dhe iniciativash që kanë kontribuar në rritjen e rolit dhe atraktivitetit të AFP-së. Ndër zhvillimet më të rëndësishme përfshihen përmirësimi i kuadrit ligjor për kualifikimet profesionale, zhvillimi i procesit mësimor me fokus të shtuar në të nxënit me bazë punën, rritja e numrit të nxënësve që ndjekin arsimin profesional, si dhe promovimi i AFP-së përmes aktiviteteve informuese, promovuese dhe konkurruese.

Një tjetër zhvillim me ndikim pozitiv ka qenë forcimi i bashkëpunimit me sektorin privat, veçanërisht përmes përfshirjes së përfaqësuesve të biznesit në bordet e institucioneve ofruese të AFP-së. Ky bashkëpunim synon rritjen e kontributit të sektorit privat në zhvillimin e AFP-së, ngushtimin e hendekut ndërmjet arsimit profesional dhe kërkesave të tregut të punës, si dhe përmirësimin e cilësisë së programeve dhe shërbimeve të ofruara.

Në bashkëpunim të ngushtë me AKAFPK-në dhe aktorë të tjerë të interesit, Programi për Zhvillimin e Aftësive për Punësim (SD4E) kontribuoi në hartimin dhe zhvillimin e modelit të sigurimit të cilësisë, duke mbështetur përcaktimin e karakteristikave dhe fizibilitetit të sistemit të ri të sigurimit të cilësisë në AFP.

Viti shkollor 2024–2025 shënoi vitin e tetë të zbatimit të procesit të vetëvlerësimit, duke dëshmuar konsolidimin gradual të kulturës së vetëvlerësimit dhe rritjen e ndërgjegjësimit të institucioneve ofruese të AFP-së mbi rëndësinë e tij për sigurimin e brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë.

Kriteret dhe standardet minimale, të përfshira në instrumentin e rishikuar të vetëvlerësimit, u zbatuan nga të gjithë ofruesit publikë dhe jopublikë të AFP-së në Shqipëri. Këto standarde përbëjnë bazën e modelit kombëtar të sigurimit të cilësisë dhe akreditimit në AFP, duke mbështetur modernizimin e sistemit dhe garantimin që të certifikuarit të pajisen me njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e nevojshme për t'iu përgjigjur kërkesave të tregut të punës.

Procesi i vetëvlerësimit, i zhvilluar nga 41 ofrues publikë dhe jopublikë të AFP-së, evidentoi pikat e forta dhe fushat që kërkojnë përmirësim në secilën prej pesë fushave të cilësisë. Gjetjet dhe rezultatet e këtij procesi përbëjnë bazën analitike për hartimin e këtij Raporti Kombëtar të Vetëvlerësimit.

KUADRI RREGULLATOR PËR VETËVLERËSIMIN NË SISTEMIN E AFP-SË NË SHQIPËRI

Kuadri strategjik

Kuadri strategjik i Arsimit dhe Formimit Profesional mbështetet në Strategjinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2023–2030, miratuar me Vendimin nr. 173, datë 24.3.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023–2030". Vizioni dhe objektivat e kësaj strategjie përbëjnë një komponent të rëndësishëm të angazhimit të Shqipërisë për zbatimin e Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe kontribuojnë në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm në fushën e punësimit, zhvillimit të aftësive dhe arsimit profesional.

Kuadri ligjor

Kuadri ligjor që rregullon sigurimin e cilësisë në sistemin e AFP-së mbështetet në një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore që përcaktojnë standardet, mekanizmat dhe përgjegjësitë institucionale për zhvillimin e proceseve të vetëvlerësimit, monitorimit dhe akreditimit.

Ligji nr. 15/2017, datë 16.2.2017, i ndryshuar, "Për arsimin dhe formimin profesional", në Kreun V "Sigurimi i Cilësisë", përcakton bazën ligjore për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të sigurimit të cilësisë në AFP. Ky kuadër përfshin mekanizmat e licencimit, vetëvlerësimit, inspektimit dhe akreditimit të institucioneve ofruese të arsimit dhe formimit profesional.

Një element themelor i këtij kuadri është edhe Ligji nr. 10247, datë 4.3.2010, "Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve", i ndryshuar, i cili përcakton strukturën, objektivat, funksionet dhe mekanizmat e menaxhimit të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), duke vendosur sigurimin e cilësisë si një nga parimet bazë të funksionimit të saj.

Në këtë kuadër, institucionet ofruese të AFP-së duhet të përmbushin standarde të përcaktuara të cilësisë në lidhje me burimet njerëzore dhe infrastrukturore, sistemet e menaxhimit, proceset e mësimdhënies dhe të nxënit, si dhe organizimin institucional. Sigurimi i cilësisë përbën një element thelbësor për garantimin e përmirësimit të vazhdueshëm të ofrimit të AFP-së, rritjen e besueshmërisë së sistemit dhe përgatitjen e një force pune të kualifikuar, në përputhje me nevojat e tregut të punës.

Gjithashtu, Ligji nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, përcakton dispozitat për zhvillimin institucional dhe sigurimin e cilësisë në institucionet arsimore parauniversitare, përfshirë ofruesit e AFP-së që ofrojnë programe të arsimit të mesëm të lartë.

Kuadri institucional për sigurimin e cilësisë në AFP

Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit (MEI)

Me Vendimin nr. 516, datë 25.9.2025, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit", është përcaktuar fusha e përgjegjësisë së këtij institucioni, e cila përfshin garantimin e së drejtës për arsim dhe formim profesional, si dhe promovimin e punësimit të sigurt dhe dinjitoz.

Në cilësinë e institucionit përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikave të Arsimit dhe Formimit Profesional, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit mbikëqyr funksionimin e rrjetit të shkollave profesionale dhe qendrave të formimit profesional.

Në fushën e sigurimit të cilësisë, Ministria ka përgjegjësi për hartimin dhe miratimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor, krijimin e mekanizmave të sigurimit të cilësisë dhe garantimin e burimeve të nevojshme njerëzore, financiare dhe infrastrukturore për funksionimin e sistemit.

Në përputhje me legjislacionin në fuqi, Ministria miraton hapjen, organizimin dhe mbylljen e ofruesve publikë dhe jopublikë të AFP-së, sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara. Gjithashtu, ajo miraton ofrimin e skeletkurrikulave mbi bazën e kualifikimeve kombëtare, si dhe standardet, kriteret dhe modelin e akreditimit të propozuara nga Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK).

Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK)

AKAFPK është institucioni përgjegjës për zhvillimin dhe administrimin e sistemit kombëtar të kualifikimeve profesionale, me synim garantimin e njohjes së tyre në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Nëpërmjet veprimtarisë së saj, Agjencia kontribuon në pajisjen e individëve me njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e nevojshme për tregun e punës dhe mbështet përafrimin e sistemit shqiptar të kualifikimeve me standardet evropiane.

Në kuadër të funksioneve që lidhen me Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), AKAFPK ushtron përgjegjësitë për zhvillimin dhe përmirësimin e sistemit të sigurimit të cilësisë në AFP. Agjencia vlerëson kualifikimet profesionale, i krahason ato me kualifikimet ndërkombëtare dhe propozon përmirësime të standardeve, kritereve dhe procedurave për sigurimin e cilësisë së kualifikimeve të përfshira në KSHK.

Në fushën e vetëvlerësimit dhe akreditimit, AKAFPK harton metodologjitë dhe instrumentet përkatëse, koordinon zbatimin e procesit të vetëvlerësimit nga institucionet ofruese të AFP-së dhe analizon rezultatet në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë në nivel sistemi.

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA)

Në përputhje me nenin 9 të Ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional", i ndryshuar, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA) është përgjegjëse për administrimin e rrjetit të ofruesve publikë dhe jopublikë të AFP-së.

Në ushtrimin e këtij mandati, AKPA monitoron funksionimin e përditshëm të institucioneve ofruese të AFP-së dhe mbështet zbatimin e politikave të zhvillimit institucional. Gjithashtu, Agjencia administron dhe përditëson regjistrin kombëtar të certifikatave, si dhe zhvillon procesin e gjurmimit të të diplomuarve dhe të certifikuarve, duke siguruar të dhëna mbi integrimin e tyre në tregun e punës. Këto të dhëna shërbejnë si një burim i rëndësishëm informacioni për vlerësimin e efektivitetit të sistemit të AFP-së dhe për orientimin e politikave të ardhshme në këtë sektor.

Kuadri strategjik, ligjor dhe institucional i përshkruar më sipër krijon bazën mbi të cilën zhvillohet procesi i vetëvlerësimit në institucionet ofruese të AFP-së. Në këtë kontekst, vetëvlerësimi shërben si mekanizmi kryesor i sigurimit të brendshëm të cilësisë, ndërsa rezultatet e tij përbëjnë një burim të rëndësishëm informacioni për monitorimin, planifikimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në nivel institucional dhe kombëtar.

INSTRUMENTI DHE METODOLOGJIA E VETËVLERËSIMIT

Metodologjia e vetëvlerësimit në Arsimin dhe Formimin Profesional mbështetet në pesë fusha kryesore të cilësisë që përbëjnë dimensionet themelore të veprimtarisë së institucioneve ofruese të AFP-së. Procesi është zhvilluar nëpërmjet një instrumenti të standardizuar vetëvlerësimi, të hartuar me mbështetjen e Programit për Zhvillimin e Aftësive për Punësim (SD4E), i cili ka shërbyer si udhëzues për zbatimin e një procesi të unifikuar, objektiv dhe të krahasueshëm ndërmjet të gjithë ofruesve.

Instrumenti i vetëvlerësimit përmban përshkrime të detajuara për secilën fushë dhe nënfushë të cilësisë, si dhe kriteret, treguesit, standardet dhe nivelet përkatëse të vlerësimit. Struktura e tij ndihmon institucionet të interpretojnë në mënyrë të njëjtë kërkesat dhe pritshmëritë për secilin aspekt të cilësisë, duke garantuar një proces vlerësimi të bazuar në kritere të përbashkëta.

Pesë fushat kryesore të vetëvlerësimit janë:

I. Menaxhimi

II. Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi

III. Kurrikula e zbatuar

IV. Mësimdhënia dhe të nxënit

V. Vlerësimi

Fushat dhe nënfushat e vetëvlerësimit

Fusha përfaqëson një dimension themelor të veprimtarisë së institucionit ofrues të AFP-së dhe lidhet me funksionet kryesore të organizimit, menaxhimit dhe ofrimit të arsimit dhe formimit profesional. Përcaktimi i fushave mbështetet në kuadrin ligjor dhe nënligjor që rregullon sistemin e AFP-së dhe arsimin parauniversitar.

Secila fushë përbëhet nga një numër nënfushash, të cilat zbërthejnë aspektet kryesore të veprimtarisë institucionale dhe mundësojnë një analizë më të detajuar të cilësisë. Për shembull, fusha "Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi" përfshin nënfusha si:

- marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me institucionet e qeverisjes qendrore, rajonale dhe vendore;
- marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me biznesin;
- forma të tjera bashkëpunimi me partnerët institucionalë dhe socialë.

Nënfushat shërbejnë për të identifikuar, analizuar dhe vlerësuar në mënyrë të detajuar funksionimin e institucionit në secilin aspekt të veprimtarisë së tij. Ato kanë dy funksione kryesore:

- zbërthejnë secilën fushë në elementët përbërës të saj;
- mundësojnë një vlerësim të detajuar dhe realist të gjendjes së institucionit.

Treguesit

Treguesit janë pohime të matshme që përshkruajnë rezultatet ose karakteristikat që pritet të realizohen në secilën nënfushë. Përmes tyre vlerësohet niveli i përmbushjes së kërkesave të instrumentit të vetëvlerësimit.

Treguesit karakterizohen nga fakti se:

- hartohen për çdo nënfushë dhe mund të jenë një ose disa për secilën prej tyre;
- janë të matshëm dhe lehtësojnë procesin e vetëvlerësimit;
- përshkruajnë në mënyrë konkrete elementet që do të vlerësohen.

Kriteret

Kriteri është një nën-ndarje e treguesve i shprehur në formën e një fjalie që përcakton si është zbatuar, si është organizuar apo në ç'gjëndje paraqitet treguesi. Ai sugjeron mbledhjen e informacioneve dhe mundëson arritjen e treguesve nga institucioni i AFP-së. Nivelet e vlerësimit janë nivelet e përdoruara për vlerësimin e institucionit të AFP-së nëpërmjet fushave të tij. Vlerësimi kryhet për çdo kriter të secilit tregues të një fushe.

Nivelet e vlerësimit

Vlerësimi kryhet për çdo kriter të secilit tregues sipas një shkalle me katër nivele të cilat janë:

- **shumë mirë** që përkon me numrin 1;
- **mirë** që përkon me numrin 2;
- **mjaftueshëm** që përkon me numrin 3;
- **dobët** që përkon me numrin 4.

Kjo shkallë vlerësimi është në përputhje me praktikat e përdorura në sistemet evropiane të sigurimit të cilësisë në arsimin dhe formimin profesional dhe mundëson një vlerësim të diferencuar të nivelit të përmbushjes së standardeve.

Për kriteret ose treguesit që nuk janë të zbatueshëm për një institucion të caktuar përdoret shënimi "NA" (Nuk aplikohet). Ky klasifikim nuk merret në konsideratë në llogaritjen e rezultatit përfundimtar të vetëvlerësimit.

Standardet

Standardet përshkruajnë nivelin e pritshëm të cilësisë për secilën fushë të vetëvlerësimit dhe shërbejnë si referencë për interpretimin e rezultateve të arritura.

Vlerësimi për secilin standard mbështetet në analizën e të dhënave dhe evidencave të mbledhura për treguesit dhe kriteret përkatëse, si dhe në informacionin e siguruar gjatë procesit të vetëvlerësimit institucional.

Rezultati përfundimtar për secilën fushë përcaktohet duke marrë në konsideratë jo vetëm numrin e kritereve të përmbushura, por edhe peshën dhe rëndësinë e tyre në funksionimin dhe cilësinë e institucionit ofrues të AFP-së.

Instrumenti i vetëvlerësimit është ndërtuar mbi një strukturë hierarkike, ku secili element mbështetet në elementin paraardhës dhe kontribuon në përcaktimin e nivelit të cilësisë së institucionit. Figura 1 paraqet strukturën e instrumentit të vetëvlerësimit dhe marrëdhëniet ndërmjet përbërësve të tij.

Figura më poshtë ofron një pamje të shpejtë të logjikës së instrumentit të vetëvlerësimit.



KALENDARI I ZBATIMIT TË PROCESIT TË VETËVLERËSIMIT

Nr.	Hapat që duhen ndërmarrë	Afatet	Personat përgjegjës
1	Krijimi i ekipit përgjegjës të vetëvlerësimit	23 Shkurt 2026	Drejtuesi i IoAFP-së
2	Miratimi i ekipit përgjegjës të vetëvlerësimit nga këshilli i mësimdhënësve	27 Shkurt 2026	Këshilli i mësimdhënësve
3	Hartimi i planit të vetëvlerësimit për 5 fushat e cilësisë	2 Mars 2026	Ekipi përgjegjës i vetëvlerësimit
4	Miratimi i planit të vetëvlerësimit nga drejtuesi i IoAFP-së	6 Mars 2026	Drejtuesi i IoAFP-së
5	Zbatimi i procesit të vetëvlerësimit për 5 fushat e cilësisë duke përdorur edhe platformën digjitale www.scvet.al (plotësimi i pyetësorëve, vëzhgime, mbledhje informacioni, etj.) ose një platformë tjetër.	13 Prill 2026	Ekipi përgjegjës i vetëvlerësimit/ Drejtuesi i IoAFP-së/Bordi i IoAFPsë/ mësimdhënësit/Stafi mbështetës/ nxënësit/kursantët/ bizneset
6	Përpunimi i të dhënave dhe hartimi i raportit të vetëvlerësimit për 5 fushat e cilësisë, duke përfshirë në raport "Instrumentin për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë"	30 Prill 2026	Ekipi përgjegjës i vetëvlerësimit
7	Përgatitja e raportit final të vetëvlerësimit për 5 fushat e cilësisë	8 Maj 2026	Ekipi përgjegjës i vetëvlerësimit
8	Monitorimi dhe mbështetja e procesit të vetëvlerësimit nga specialistë të AKAFPK-së	Shkurt-Maj 2026	Specialistë të AKAFPK-së
9	Prezantimi i raportit final të vetëvlerësimit në këshillin e mësimdhënësve dhe miratimi i tij nga bordi i IoAFP-së	13 Maj 2026	Drejtuesi i IoAFP-së/ këshilli i mësimdhënësve /Bordi i IoAFP-së
10	Hedhja e raportit final të vetëvlerësimit në platformën digjitale www.scvet.al ose në e-mailin zyrtar në info.akafp@akafp.gov.al	22 Maj 2026	Drejtuesi i IoAFP-së

REZULTATET E PROCESIT TË VETËVLERËSIMIT, VITI SHKOLLOR 2024–2025

Procesi i vetëvlerësimit për vitin shkollor 2024–2025 u përmbyll me dorëzimin e raporteve të vetëvlerësimit nga 41 institucione ofruese të Arsimit dhe Formimit Profesional, publike dhe jopublike. Raportet u shqyrtuan, u përpunuan dhe u analizuan nga Sektori i Akreditimit të Ofruesve të AFP-së në Agjencinë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, duke u mbështetur në analizën e të dhënave sasiore dhe cilësore të raportuara nga institucionet.

Në kuadër të këtij procesi, AKAFPK zhvilloi takime individuale me secilin prej 41 ofruesve të AFP-së. Këto takime shërbyen për të diskutuar rezultatet e vetëvlerësimit, për të ofruar mbështetje metodologjike gjatë procesit dhe për të identifikuar fushat ku nevojiten ndërhyrje për përmirësimin e cilësisë.

Ky raport paraqet një analizë të konsoliduar të rezultateve të vetëvlerësimit në nivel kombëtar, të organizuar sipas pesë fushave të cilësisë dhe nënfushave përkatëse të instrumentit të vetëvlerësimit. Për secilën nënfushë evidentohen pikat e forta dhe fushat që kërkojnë përmirësim, bazuar në analizën e raporteve të dorëzuara nga institucionet.

Për të mbështetur interpretimin e rezultateve, analiza shoqërohet me paraqitje grafike të të dhënave për secilin ofrues të AFP-së, të kombinuara me interpretimin cilësor të gjetjeve. Në përfundim të secilës fushë të cilësisë janë formuluar rekomandime të orientuara drejt përmirësimit të vazhdueshëm të performancës institucionale dhe forcimit të sistemit të sigurimit të cilësisë në Arsimin dhe Formimin Profesional.

Rezultatet e paraqitura në këtë kapitull pasqyrojnë vetëvlerësimin e institucioneve ofruese të AFP-së për secilën fushë dhe nënfushë të instrumentit të vetëvlerësimit. Analiza është ndërtuar mbi të dhënat e raportuara nga institucionet dhe synon të evidentojë prirjet kryesore në nivel kombëtar, duke identifikuar njëkohësisht praktikat pozitive dhe fushat që kërkojnë përmirësim.

FUSHA 1: MENAXHIMI

Procesi i vetëvlerësimit për vitin 2024–2025 u zbatua nga institucionet ofruese të Arsimit dhe Formimit Profesional (IoAFP) në përputhje me kërkesat e instrumentit të vetëvlerësimit dhe afatet e përcaktuara në kalendarin zyrtar të procesit. Të gjithë ofruesit dorëzuan raportet përkatëse pranë AKAFPK-së, duke paraqitur të dhëna dhe evidenca mbi organizimin dhe funksionimin e tyre institucional.

Gjatë analizës së fushës së parë, "Menaxhimi", u evidentua se IoAFP-të kanë krijuar struktura të brendshme pune për zhvillimin e procesit të vetëvlerësimit, përmes ngritjes së grupeve të punës, përcaktimit të roleve dhe përgjegjësive, si dhe organizimit të proceseve të nevojshme për mbledhjen dhe përpunimin e informacionit.

Një element pozitiv i identifikuar gjatë procesit ishte përfshirja e stafit mësimdhënës në hartimin e raporteve të vetëvlerësimit. Ky bashkëpunim ka kontribuar në zhvillimin e një

procesi më transparent dhe gjithëpërfshirës, duke nxitur reflektimin institucional mbi praktikat e menaxhimit, arritjet dhe fushat që kërkojnë përmirësim.

Në vijim paraqiten nënfushat përkatëse dhe zhvillimet kryesore të evidentuara në nivel kombëtar për të gjithë IoAFP-të.

1.1 Gjithëpërfshirja
1.2 Plani afatmesëm i IoAFP-së
1.3 Plani vjetor i IoAFP-së
1.4 Plani i monitorimit institucional
1.5 Regjistrimet, transferimet dhe statistikat
1.6 Procesi i vetëvlerësimit
1.7 Zhvillimi profesional i stafit
1.8 Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe financiare

1.1 Gjithëpërfshirja

a. Pikat e forta

- Në IoAFP janë ngritur dhe funksionojnë organizmat e detyrueshëm të shkollës, si Bordi, Këshilli i Mësuesve, Këshilli i Prindërve, Qeveria e Nxënësve dhe komisionet e tjera funksionale, duke mbështetur një strukturë të mirëorganizuar të menaxhimit institucional.
- Procesi i hartimit të planeve institucionale dhe vendimmarrja karakterizohen nga përfshirja e grupeve të interesit, duke promovuar një qasje pjesëmarrëse dhe transparente në drejtimin e institucionit.
- Në përbërjen e organizmave drejtues dhe këshillimorë respektohet parimi i barazisë gjinore, çka dëshmon për zbatimin e praktikave gjithëpërfshirëse në organizimin institucional.
- Bashkëpunimi ndërmjet stafit dhe puna në ekipe janë të konsoliduara si pjesë e kulturës organizative të IoAFP-ve, duke lehtësuar koordinimin e proceseve dhe realizimin e objektivave institucionale.
- Drejtuesit e institucioneve angazhojnë organizmat e shkollës në proceset konsultuese, duke kërkuar mendime dhe sugjerime për çështje që lidhen me menaxhimin dhe zhvillimin institucional.

b. Aspektet që kërkojnë përmirësim

- Nga analiza e raporteve evidentohet se përfshirja e prindërve në jetën dhe veprimtaritë e IoAFP-ve mbetet e kufizuar, duke reduktuar kontributin e tyre në proceset e zhvillimit dhe përmirësimit institucional.
- Në një pjesë të institucioneve nuk përdoren në mënyrë sistematike instrumente për vlerësimin e kënaqësisë së grupeve të interesit, çka kufizon mbledhjen e informacionit

të strukturuar dhe përdorimin e tij në procesin e vendimmarrjes dhe përmirësimit të cilësisë.
- Analiza tregon se, megjithëse grupet e interesit përfshihen në proceset institucionale, në disa raste kjo përfshirje mbetet kryesisht formale. Kjo evidencon nevojën për forcimin e mekanizmave që sigurojnë një pjesëmarrje më aktive dhe me ndikim real në vendimmarrjen dhe zhvillimin e institucionit.

1.2 Plani afatmesëm i IoAFP-së

a. Pikat e forta

- Analiza e raporteve të vetëvlerësimit tregon se në shumicën e IoAFP-ve plani afatmesëm është hartuar në përputhje me formatin e miratuar dhe kuadrin ligjor në fuqi, duke siguruar një bazë të standardizuar për planifikimin institucional.
- Objektivat strategjikë të planit afatmesëm janë përgjithësisht të harmonizuar me prioritetet e zhvillimit të institucionit dhe nevojat e identifikuara, duke orientuar veprimtarinë drejt përmirësimit të cilësisë.
- Në pjesën më të madhe të institucioneve, plani afatmesëm miratohet nga Bordi i institucionit dhe i nënshtrohet monitorimit periodik, çka kontribuon në ndjekjen e zbatimit të objektivave dhe masave të planifikuara.
- Planet afatmesme përfshijnë elemente që lidhen me gjithëpërfshirjen dhe barazinë gjinore, duke reflektuar angazhimin e institucioneve për zbatimin e parimeve të arsimit gjithëpërfshirës dhe mundësive të barabarta.

b. Aspektet që kërkojnë përmirësim

- Nga analiza evidentohet se dokumentimi i procesit të konsultimit me grupet e interesit nuk realizohet në mënyrë të njëtrajtshme në të gjitha IoAFP-të. Në disa raste mungojnë evidencat që dëshmojnë përfshirjen e aktorëve në hartimin dhe rishikimin e planit afatmesëm, çka kufizon transparencën dhe gjurmueshmërinë e procesit..

1.3 Plani vjetor i IoAFP-së

a. Pikat e forta

- Analiza e raporteve të vetëvlerësimit tregon se në shumicën e IoAFP-ve plani vjetor hartohet në përputhje me formatin zyrtar dhe kërkesat e përcaktuara për planifikimin institucional.
- Plani vjetor paraqet një lidhje të qartë me objektivat dhe prioritetet e planit afatmesëm, duke siguruar vazhdimësi në zbatimin e strategjisë së zhvillimit të institucionit.
- Në pjesën më të madhe të institucioneve, hartimi i planit vjetor paraprihet nga konsultimi me grupet e interesit, duke nxitur një proces planifikimi më gjithëpërfshirës dhe transparent.

- Objektivat e përcaktuara në planin vjetor janë, në përgjithësi, specifike, të matshme, të arritshme, relevante dhe të përcaktuara në kohë (SMART), ndërsa zbatimi i tyre monitorohet përmes planeve mujore të punës.
- Planet vjetore miratohen nga Bordi i institucionit dhe publikohen, duke garantuar respektimin e procedurave institucionale dhe rritjen e transparencës ndaj komunitetit të shkollës.

b. Aspektet që kërkojnë përmirësim

- Nga analiza evidentohet se në disa IoAFP planifikimi vjetor nuk pasqyron në mënyrë të plotë masat e përcaktuara në planin e përmirësimit, të hartuar mbi bazën e rezultateve të procesit të vetëvlerësimit. Kjo tregon nevojën për një lidhje më të fortë ndërmjet vetëvlerësimit dhe planifikimit vjetor.
- Në një pjesë të institucioneve nuk planifikohen objektiva që lidhen me zhvillimin e ofertave të reja arsimore dhe të formimit profesional, kryesisht për shkak të kufizimeve në infrastrukturë, pajisje dhe burime mbështetëse. Kjo kufizon mundësitë për zgjerimin e ofertës në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe zhvillimet e sektorëve prioritarë.

1.4 Plani i monitorimit institucional

a. Pikat e forta

- Analiza e raporteve të vetëvlerësimit tregon se janë hartuar dhe zbatohen plane të monitorimit institucional, të cilat mbulojnë monitorimin e procesit mësimor dhe të veprimtarisë operative të institucionit.
- Institucionet përdorin instrumente të standardizuara për vëzhgimin e orëve mësimore, duke mundësuar një vlerësim të strukturuar dhe të njëtrajtshëm të procesit të mësimdhënies.
- Gjetjet e monitorimit dokumentohen dhe përdoren si pjesë e procesit të vlerësimit të performancës së mësimdhënësve, duke mbështetur identifikimin e nevojave për zhvillim profesional dhe përmirësimin e praktikave pedagogjike.
- Procesi i monitorimit përfshin, në përgjithësi, kontrollin e dokumentacionit pedagogjik, realizimin e praktikave profesionale, si dhe zhvillimin e orëve edukative, duke siguruar ndjekjen e zbatimit të veprimtarive të planifikuara.

b. Aspektet që kërkojnë përmirësim

- Nga analiza evidentohet se monitorimi institucional nuk realizohet në mënyrë të njëtrajtshme dhe sistematike në të gjitha IoAFP-të, duke ndikuar në efektivitetin e ndjekjes dhe vlerësimit të proceseve kryesore të institucionit.
- Përvojat dhe praktikat e mira të identifikuara gjatë monitorimit nuk dokumentohen dhe nuk shpërndahen në mënyrë sistematike me të gjithë stafin mësimdhënës, duke kufizuar

mundësitë për të nxitur të nxënit institucional dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.
- Në një pjesë të institucioneve nevojitet një monitorim më i strukturuar i planifikimit dhe përdorimit të bazës materiale për zhvillimin e praktikave profesionale, me qëllim sigurimin e kushteve të përshtatshme për realizimin e komponentit praktik të programeve të AFP-së.

1.5 Regjistrimet, transferimet dhe statistikat

a. Pikat e forta

- Analiza e raporteve të vetëvlerësimit tregon se në shumicën e IoAFP-ve respektohen procedurat ligjore që rregullojnë proceset e regjistrimit dhe transferimit të nxënësve, duke garantuar zbatimin e kuadrit normativ në fuqi.
- Dokumentacioni që lidhet me regjistrimet, transferimet dhe administrimin e të dhënave evidentohet se mbahet dhe administrohet në përputhje me legjislacionin përkatës, duke siguruar gjurmueshmërinë dhe administrimin korrekt të proceseve.
- Institucionet realizojnë në kohë raportimet statistikore të kërkuara, duke kontribuar në disponueshmërinë e të dhënave për monitorimin e veprimtarisë institucionale dhe raportimin në nivel kombëtar.
- Përdorimi i Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP), i kombinuar me administrimin e dokumentacionit sipas kërkesave ligjore, mbështet menaxhimin e të dhënave dhe rrit besueshmërinë e informacionit institucional.

b. Aspektet që kërkojnë përmirësim

- Nga analiza e raporteve nuk evidentohen mangësi të theksuara në zbatimin e procedurave për regjistrimet, transferimet dhe administrimin e statistikave, çka tregon një nivel të mirë funksionimi të kësaj nënfushe.
- Megjithatë, evidentohet nevoja për një përdorim më të avancuar të të dhënave statistikore, përmes analizës së tyre sistematike në funksion të planifikimit strategjik, monitorimit të treguesve të performancës dhe mbështetjes së proceseve të vendimmarrjes institucionale.

1.6 Procesi i vetëvlerësimit

a. Pikat e forta

- Analiza e raporteve të vetëvlerësimit tregon se në të gjitha IoAFP-të procesi i vetëvlerësimit realizohet çdo vit, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kalendarin e miratuar nga AKAFPK-ja, duke siguruar zbatimin e një procesi të standardizuar në nivel kombëtar.

- Procesi i vetëvlerësimit mbështetet në përdorimin e evidencave dhe instrumenteve zyrtare të vlerësimit, çka kontribuon në rritjen e besueshmërisë dhe objektivitetit të gjetjeve të evidentuara.
- Raportet e vetëvlerësimit publikohen dhe ruhen në arkivin e institucionit, duke garantuar transparencën, dokumentimin dhe gjurmueshmërinë e procesit.
- Në shumicën e IoAFP-ve, rezultatet dhe gjetjet e procesit të vetëvlerësimit shërbejnë si bazë për hartimin e planit të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë, duke e orientuar zhvillimin institucional drejt adresimit të nevojave dhe prioriteteve të identifikuara.

b. Aspektet që kërkojnë përmirësim

- Nga analiza e raporteve evidentohet se, në disa IoAFP, rezultatet dhe rekomandimet e procesit të vetëvlerësimit nuk reflektohen plotësisht në planifikimin vjetor të institucionit. Kjo tregon nevojën për forcimin e lidhjes ndërmjet vetëvlerësimit, planifikimit institucional dhe zbatimit të masave konkrete për përmirësimin e cilësisë.

1.7 Zhvillimi profesional i stafit

a. Pikat e forta

- Analiza e raporteve të vetëvlerësimit tregon se në IoAFP-të identifikohen nevojat për zhvillim profesional të stafit, duke u bazuar në kërkesat e institucionit, rezultatet e monitorimit dhe nevojat e identifikuara gjatë procesit të vetëvlerësimit.
- Institucionet disponojnë dhe mirëmbajnë databaza për dokumentimin e pjesëmarrjes së stafit në aktivitete të zhvillimit profesional, duke mundësuar administrimin dhe gjurmueshmërinë e të dhënave për trajnimet e realizuara.
- Në shumicën e IoAFP-ve hartohen dhe zbatohen plane trajnimi për stafin, të cilat synojnë përmirësimin e kompetencave profesionale dhe pedagogjike në përputhje me nevojat e institucionit.
- Mësuesit e rinj mbështeten përmes mekanizmave të mentorimit, duke lehtësuar integrimin e tyre në institucion dhe zhvillimin e praktikave profesionale në fazat e para të angazhimit të tyre.

b. Aspektet që kërkojnë përmirësim

- Nga analiza evidentohet nevoja për zgjerimin e pjesëmarrjes së stafit në programe trajnimi të certifikuara, me qëllim përditësimin e vazhdueshëm të kompetencave profesionale dhe përshtatjen me zhvillimet e reja në fushën e AFP-së.
- Në disa IoAFP nevojitet forcimi i mekanizmave për monitorimin dhe analizën e ndikimit të trajnimeve të zhvilluara në performancën e stafit dhe në përmirësimin e procesit mësimor. Vlerësimi i rezultateve të trajnimeve do të mundësonte një orientim më të mirë të planeve të zhvillimit profesional në të ardhmen.

1.8 Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe financiare

a. Pikat e forta

- Analiza e raporteve të vetëvlerësimit tregon se IoAFP-të realizojnë planifikimin periodik të nevojave për staf mësimdhënës dhe mbështetës, duke u bazuar në kërkesat e strukturës organizative, numrin e nxënësve dhe ofertën arsimore të institucionit.
- Proceset e rekrutimit të stafit realizohen në përputhje me procedurat dhe kërkesat ligjore në fuqi, duke garantuar transparencë dhe respektimin e kritereve të përcaktuara.
- Rolet, përgjegjësitë dhe detyrat e anëtarëve të stafit janë të përcaktuara dhe të dokumentuara, duke mbështetur organizimin efektiv të punës dhe funksionimin institucional.
- Menaxhimi financiar realizohet përmes planifikimit dhe administrimit të buxhetit në përputhje me prioritetet, objektivat dhe nevojat e institucionit, duke orientuar përdorimin e burimeve drejt realizimit të veprimtarive kryesore.
- Inventari i pajisjeve dhe pasurive të institucionit mbahet dhe administrohet në formë fizike dhe elektronike, duke kontribuar në menaxhimin më të mirë të aseteve institucionale.
- Dokumentacioni financiar rezulton i plotë dhe i administruar në mënyrë transparente, duke siguruar gjurmueshmëri dhe kontroll të proceseve financiare.

b. Aspektet që kërkojnë përmirësim

- Nga analiza evidentohet se gjatë periudhës së vlerësimit nuk është realizuar auditim i jashtëm financiar, çka tregon nevojën për forcimin e mekanizmave të kontrollit të jashtëm dhe rritjen e sigurisë mbi efektivitetin e menaxhimit financiar.
- Në disa raste nevojitet përmirësimi i dokumentimit të proceseve të monitorimit të stafit dhe i evidencave të takimeve me prindërit, me qëllim rritjen e saktësisë, gjurmueshmërisë dhe përdorimit të këtyre të dhënave në proceset e menaxhimit institucional.
- Evidentohet nevoja për një dokumentim më të strukturuar të kërkesave për bazën materiale të nevojshme për zhvillimin e praktikave profesionale, duke siguruar një lidhje më të qartë ndërmjet nevojave të identifikuara, planifikimit financiar dhe sigurimit të kushteve për realizimin cilësor të komponentit praktik të AFP-së.

Vlerësim i përgjithshëm për Fushën 1

Nga analiza e të dhënave të raportuara nga IoAFP-të rezulton se **Fusha 1 – "Menaxhimi"** paraqet një nivel të mirë të përputhshmërisë me kërkesat e standardeve të sigurimit të cilësisë dhe me kuadrin rregullator në fuqi. Institucionet kanë krijuar struktura funksionale menaxhimi, kanë zbatuar procese të planifikimit institucional dhe kanë zhvilluar mekanizma për monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të veprimtarisë së tyre.

Pikat më të konsoliduara lidhen me organizimin e strukturave drejtuese dhe pjesëmarrëse të institucionit, hartimin dhe zbatimin e planeve institucionale, menaxhimin e burimeve njerëzore dhe financiare, si dhe realizimin e procesit të vetëvlerësimit mbi bazën e evidencave dhe instrumenteve të standardizuara. Këto elemente dëshmojnë për një qasje të orientuar drejt planifikimit, dokumentimit dhe sigurimit të cilësisë në nivel institucional.

Megjithatë, analiza evidenton disa nënfusha ku kërkohet përmirësim i mëtejshëm. Prioritet mbetet forcimi i përfshirjes reale të prindërve dhe grupeve të interesit në proceset institucionale, përtej pjesëmarrjes formale, si dhe përdorimi më sistematik i instrumenteve për matjen e kënaqësisë së tyre. Gjithashtu, nevojitet forcimi i lidhjes ndërmjet rezultateve të vetëvlerësimit dhe planifikimit institucional, zgjerimi i ofertave të reja të AFP-së në përputhje me nevojat e tregut të punës, si dhe përmirësimi i monitorimit të proceseve mësimore dhe dokumentimit të evidencave institucionale.

Në tërësi, Fusha 1 paraqet një bazë të qëndrueshme menaxhimi, ndërsa sfida kryesore mbetet kalimi nga zbatimi korrekt i procedurave drejt një menaxhimi më të orientuar nga analiza e të dhënave, përmirësimi i vazhdueshëm dhe ndikimi i matshëm në cilësinë e ofrimit të AFP-së.

Në formë grafike rezultati i fushës për ofruesit e AFP-së do të paraqitej si më poshtë.



FUSHA 2 - MARRËDHËNIET DHE BASHKËPUNIMI

Fusha 2 - "Marrëdhëniet dhe Bashkëpunimi" fokusohet në vlerësimin e mënyrës se si institucionet ofruese të Arsimit dhe Formimit Profesional (IoAFP) ndërtojnë dhe zhvillojnë marrëdhënie me aktorë të ndryshëm institucionalë, ekonomikë dhe shoqërorë. Kjo fushë vlerëson kapacitetin e ofruesve të AFP-së për të krijuar partneritete funksionale që mbështesin

përmirësimin e cilësisë së ofertës arsimore, përshtatjen me nevojat e tregut të punës dhe rritjen e efektivitetit institucional.
IoAFP-të kanë mundësi të zhvillojnë forma të ndryshme bashkëpunimi me institucionet publike, sektorin privat, organizatat e shoqërisë civile, komunitetin dhe institucione të tjera arsimore, në përputhje me misionin dhe objektivat e tyre strategjike. Këto marrëdhënie kontribuojnë në forcimin e lidhjes ndërmjet AFP-së dhe tregut të punës, në përmirësimin e përvojës së të nxënit të nxënësve, si dhe në rritjen e rolit të institucioneve si aktorë aktivë në zhvillimin ekonomik dhe social të komunitetit.
Analiza e kësaj fushe synon të evidentojë nivelin e angazhimit të IoAFP-ve në krijimin e partneriteteve, efektivitetin e mekanizmave të bashkëpunimit, si dhe ndikimin e tyre në realizimin e objektivave institucionale dhe sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë.

Fusha 2 përbëhet nga katër nënfushat në vijim:
2.1 Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me qeverisjen qendrore, rajonale dhe vendore
2.2 Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me biznesin
2.3 Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me komunitetin, organizata të shoqërisë civile, donatorët dhe aktorë të tjerë
2.4 Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi midis IoAFP dhe institucioneve arsimore

2.1 Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me qeverisjen qendrore, rajonale dhe vendore

a. Pikat e forta

- Analiza e raporteve të vetëvlerësimit tregon se IoAFP-të kanë ndërtuar marrëdhënie funksionale dhe të qëndrueshme bashkëpunimi me institucionet qendrore, rajonale dhe vendore përgjegjëse për AFP-në dhe arsimin parauniversitar, duke mbështetur koordinimin institucional dhe zbatimin e politikave arsimore.
- Komunikimi institucional dhe shkëmbimi i dokumentacionit zyrtar realizohen në mënyrë të rregullt dhe dokumentohen në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurat administrative në fuqi.
- IoAFP-të zbatojnë me korrektësi udhëzimet, aktet administrative dhe kërkesat e institucioneve përgjegjëse, duke reflektuar një nivel të mirë përputhshmërie me kuadrin rregullator.
- Institucionet marrin pjesë në mënyrë aktive në takime koordinuese, aktivitete kombëtare, procese monitorimi dhe veprimtari të organizuara nga strukturat përgjegjëse, duke kontribuar në shkëmbimin e informacionit dhe harmonizimin e veprimtarive institucionale.
- Bashkëpunimi me njësitë e qeverisjes vendore kontribuon në mbështetjen e nxënësve përmes ofrimit të bursave dhe formave të tjera të asistencës, veçanërisht për kategoritë sociale dhe nxënësit me nevoja të veçanta.
- Përfaqësues të institucioneve vendore janë të përfshirë në strukturat drejtuese dhe aktivitetet institucionale të IoAFP-ve, duke nxitur një qasje më të hapur dhe më të lidhur me komunitetin.

- Marrëdhëniet me institucionet publike kontribuojnë në promovimin e arsimit profesional, rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e AFP-së dhe orientimin e nxënësve drejt mundësive të punësimit dhe nevojave të tregut të punës.

b. Aspektet që kërkojnë përmirësim

- Nga analiza evidentohet se në disa IoAFP komunikimi me institucionet e qeverisjes vendore nuk është zhvilluar në mënyrë të vazhdueshme dhe gjithëpërfshirëse, duke krijuar nevojën për forcimin e mekanizmave të dialogut dhe bashkëpunimit periodik.
- Evidentohet nevoja për zhvillimin e më shumë aktiviteteve të përbashkëta me institucionet publike dhe aktorët vendorë në fushën e barazisë gjinore dhe gjithëpërfshirjes, me qëllim promovimin e një mjedisi më të barabartë dhe mbështetës për të gjithë nxënësit.

2.2 Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me biznesin

a. Pikat e forta

- Analiza e raporteve të vetëvlerësimit tregon se IoAFP-të kanë ndërtuar dhe përditësojnë databaza të bizneseve partnere sipas fushave dhe kualifikimeve profesionale që ofrojnë, duke mbështetur identifikimin e mundësive për bashkëpunim dhe zhvillimin e praktikave profesionale.
- Në institucionet ofruese funksionojnë Njësitë e Zhvillimit dhe roli i Koordinatorit të Marrëdhënieve me Biznesin, duke kontribuar në krijimin, menaxhimin dhe forcimin e lidhjeve me sektorin privat.
- Janë formalizuar marrëdhëniet me biznesin përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe kontratave për zhvillimin e praktikave profesionale të nxënësve, duke siguruar një kuadër të strukturuar për realizimin e komponentit praktik të AFP-së.
- Praktikat profesionale monitorohen dhe dokumentohen në mënyrë sistematike, duke mundësuar ndjekjen e progresit të nxënësve dhe vlerësimin e realizimit të objektivave të praktikës.
- Përfaqësues të biznesit përfshihen në hartimin e programeve të praktikës profesionale dhe në proceset e vlerësimit të nxënësve, duke rritur lidhjen ndërmjet kërkesave të tregut të punës dhe formimit profesional të ofruar.
- Bashkëpunimi me bizneset ka kontribuar në mbështetjen e punësimit dhe gjurmimin e të diplomuarve/kursantëve, duke ndihmuar institucionet në vlerësimin e rezultateve të ofertës së tyre arsimore.
- IoAFP-të organizojnë aktivitete të përbashkëta me profesionistë të biznesit, si orë të hapura, prezantime profesionale dhe takime orientuese, duke krijuar mundësi për shkëmbimin e përvojave dhe njohjen e nxënësve me realitetin e profesionit.
- Në disa institucione është zbatuar modeli i "Arsimit të dyfishtë" në kualifikime të caktuara profesionale, duke forcuar lidhjen ndërmjet procesit të të nxënit dhe kërkesave konkrete të sektorit ekonomik.

b. Aspektet që kërkojnë përmirësim

- Nga analiza evidentohet se "Arsimit të dyfishtë" nuk është ende i shtrirë në të gjitha IoAFP-të dhe në të gjitha kualifikimet profesionale, duke treguar nevojën për zgjerimin gradual të këtij modeli në përputhje me kapacitetet e institucioneve dhe interesin e biznesit.
- Në disa raste, mungon mbështetja financiare nga bizneset për zhvillimin e praktikave profesionale, çka kufizon mundësitë për përmirësimin e cilësisë së përvojës praktike të nxënësve dhe sigurimin e kushteve të përshtatshme në vendin e punës.
- Procesi i validimit të të nxënit joformal dhe informal nuk është zhvilluar ende në mënyrë të plotë, duke kufizuar mundësitë për njohjen dhe certifikimin e kompetencave të fituara jashtë sistemit formal të AFP-së.
- Në disa IoAFP përfaqësuesit e biznesit nuk janë përfshirë në mënyrë të rregullt në komisionet e provimeve përfundimtare, duke evidentuar nevojën për forcimin e rolit të sektorit privat në vlerësimin e kompetencave profesionale.
- Mbështetja dhe përshtatja e vendeve të praktikës për nxënësit me aftësi të kufizuara mbetet e kufizuar në disa raste, duke kërkuar masa më të strukturuara për garantimin e aksesit dhe gjithëpërfshirjes në mjediset e punës.
- Bashkëpunimi ndërmjet instruktorëve të biznesit dhe mësuesve të praktikës profesionale ka nevojë për forcim të mëtejshëm, përmes komunikimit më të rregullt, planifikimit të përbashkët dhe shkëmbimit të informacionit mbi progresin e nxënësve.

2.3 Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me komunitetin, organizatat e shoqërisë civile, donatorët dhe aktorë të tjerë

a. Pikat e forta

- Analiza e raporteve të vetëvlerësimit tregon se IoAFP-të zhvillojnë marrëdhënie të vazhdueshme me komunitetin dhe prindërit përmes strukturave institucionale, si Këshilli i Prindërve, si dhe përmes aktiviteteve të përbashkëta me komunitetin e shkollës.
- Institucionet organizojnë aktivitete ndërgjegjësuese që lidhen me çështje të rëndësishme sociale dhe edukative, si mbrojtja e mjedisit, barazia gjinore dhe gjithëpërfshirja, duke kontribuar në krijimin e një mjedisi më të hapur dhe mbështetës për nxënësit.
- IoAFP-të bashkëpunojnë me organizata të shoqërisë civile dhe donatorë në kuadër të projekteve edukative, sociale dhe zhvillimore, duke krijuar mundësi për mbështetje të proceseve institucionale dhe përmirësimin e shërbimeve të ofruara.
- Janë realizuar projekte që kanë kontribuar në zhvillimin institucional, përmirësimin e kushteve të të nxënit dhe mbështetjen e përfshirjes sociale të nxënësve.
- Dokumentacioni i projekteve administrohet dhe rezultatet e aktiviteteve të realizuara publikohen, duke garantuar transparencë dhe gjurmueshmëri të veprimtarive të zhvilluara.

- Në aktivitetet dhe projektet e zbatuara përfshihen stafi dhe nxënësit, duke nxitur angazhimin e komunitetit të shkollës dhe zhvillimin e kompetencave sociale e profesionale.

b. **Aspektet që kërkojnë përmirësim**

- Nga analiza evidentohet nevoja për forcimin e mëtejshëm të rolit të prindërve në proceset vendimmarrëse dhe në jetën institucionale, duke kaluar nga pjesëmarrja kryesisht konsultative drejt një përfshirjeje më aktive dhe me ndikim.
- Në disa IoAFP mungon një plan i strukturuar pune për Këshillin e Prindërve, çka kufizon organizimin sistematik të veprimtarive dhe kontributin e tij në zhvillimin institucional.
- Bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile dhe donatorët nuk paraqitet në të njëjtin nivel në të gjitha institucionet. Në disa raste këto marrëdhënie mbeten sporadike dhe të varura nga mundësi individuale ose projekte të veçanta.
- Evidentohet se disa projekte të fituara nuk janë zbatuar ende në disa IoAFP, duke treguar nevojën për forcimin e kapaciteteve institucionale për menaxhimin, zbatimin dhe ndjekjen e projekteve.
- Mbështetja për grupet në nevojë kërkon zgjerim të mëtejshëm përmes zhvillimit të projekteve dhe partneriteteve të reja që synojnë rritjen e aksesit, barazisë së mundësive dhe gjithëpërfshirjes në AFP.

2.4 Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi midis IoAFP dhe institucioneve arsimore

a. **Pikat e forta**

- Analiza e raporteve të vetëvlerësimit tregon se IoAFP-të zhvillojnë bashkëpunime me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, si dhe në disa raste me institucione të arsimit të lartë, përmes shkëmbimit të përvojave, vizitave studimore dhe aktiviteteve të zhvillimit profesional.
- Institucionet kanë krijuar dhe mirëmbajnë databaza të bashkëpunimit me institucione të tjera arsimore, duke lehtësuar identifikimin e partnerëve dhe ndjekjen e marrëdhënieve institucionale të krijuara.
- IoAFP-të zhvillojnë veprimtari të marketingut institucional dhe këshillimit të karrierës, duke kontribuar në informimin e nxënësve të ardhshëm, promovimin e ofertës profesionale dhe orientimin e tyre drejt zgjedhjeve të informuara arsimore e profesionale.
- Organizohen aktivitete promovuese, si "Ditët e Hapura", panaire profesionale dhe veprimtari orientuese, të cilat rrisin vizibilitetin e institucioneve dhe forcojnë lidhjen me nxënësit, prindërit dhe komunitetin.
- Pjesëmarrja në projekte dhe bashkëpunime ndërkombëtare ka kontribuar në rritjen e kapaciteteve institucionale, shkëmbimin e praktikave të mira dhe përmirësimin e cilësisë së ofrimit të kualifikimeve profesionale.

b. Aspektet që kërkojnë përmirësim

- Nga analiza evidentohet se bashkëpunimi me institucionet e arsimit të lartë për hartimin e materialeve mësimore mbështetëse nuk realizohet në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha IoAFP-të. Forcimi i këtij bashkëpunimi do të ndihmonte në përditësimin e burimeve mësimore dhe në rritjen e cilësisë së përmbajtjeve të përdorura në procesin e të nxënit.
- Në disa institucione mungojnë programe të strukturuara trajnimi dhe zhvillimi profesional të stafit të realizuara në bashkëpunim me universitetet dhe institucionet e tjera të arsimit të lartë, duke kufizuar mundësitë për shkëmbim ekspertize dhe përditësim të kompetencave profesionale.
- Bashkëpunimet ndërkombëtare paraqesin mundësi për zgjerim të mëtejshëm, veçanërisht përmes rritjes së pjesëmarrjes në projekte, rrjete profesionale dhe iniciativa që mundësojnë transferimin e praktikave të mira evropiane në AFP.

Vlerësim i përgjithshëm për Fushën 2

Nga analiza e të dhënave të paraqitura në raportet e vetëvlerësimit rezulton se Fusha 2 – "Marrëdhëniet dhe Bashkëpunimi" paraqet një nivel të mirë dhe të konsoliduar të zhvillimit institucional. IoAFP-të kanë ndërtuar marrëdhënie dhe partneritete me aktorë të ndryshëm, përfshirë institucionet qendrore, rajonale dhe vendore, biznesin, komunitetin, organizatat e shoqërisë civile, donatorët dhe institucione të tjera arsimore.

Bashkëpunimi me biznesin paraqitet si një nga elementet më të zhvilluara të kësaj fushe, veçanërisht në lidhje me realizimin e praktikave profesionale, përfshirjen e sektorit privat në proceset e formimit dhe mbështetjen për orientimin e nxënësve drejt tregut të punës. Gjithashtu, marrëdhëniet me institucionet publike dhe ato arsimore kanë kontribuar në koordinimin institucional, shkëmbimin e përvojave dhe zhvillimin profesional të stafit dhe nxënësve.

Megjithatë, analiza evidenton disa drejtime ku kërkohet përmirësim i mëtejshëm. Prioritet mbetet zgjerimi i modelit të "Arsimit të dyfishtë" në më shumë institucione dhe kualifikime profesionale, forcimi i rolit aktiv të prindërve dhe komunitetit në jetën institucionale, si dhe zhvillimi i partneriteteve më të strukturuara me institucionet e arsimit të lartë për mbështetjen e zhvillimit të kurrikulave dhe burimeve mësimore.

Gjithashtu, nevojitet zgjerimi i bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile dhe donatorët përmes projekteve më të qëndrueshme dhe me ndikim të matshëm në përmirësimin e kushteve të të nxënit, gjithëpërfshirjes dhe zhvillimit institucional.

Në tërësi, Fusha 2 tregon se IoAFP-të kanë krijuar një bazë të mirë partneritetesh dhe bashkëpunimesh, ndërsa sfida kryesore mbetet transformimi i këtyre marrëdhënieve nga bashkëpunime funksionale në partneritete strategjike, të qëndrueshme dhe të orientuara drejt rezultateve të matshme.

Në formë grafike rezultati i fushës për ofruesit e AFP-së do të paraqitej si më poshtë.



FUSHA 3-KURRIKULA E ZBATUAR

Fusha 3 – Kurrikula e Zbatuar fokusohet në mënyrën se si institucionet ofruese të Arsimit dhe Formimit Profesional planifikojnë, organizojnë dhe zbatojnë kurrikulën në nivel ofruesi, në përputhje me standardet e profesioneve, standardet e kualifikimeve profesionale dhe kërkesat e tregut të punës. Kjo fushë vlerëson kapacitetin e institucioneve për të garantuar zhvillimin e kompetencave profesionale dhe kompetencave kyçe të nxënësve/individëve, përmes një procesi mësimor të strukturuar dhe të orientuar drejt rezultateve të të nxënit.

Programet e mësimdhënies në IoAFP hartohen dhe zbatohen në përputhje me skeletkurrikulat e miratuara për kualifikimet profesionale, duke siguruar respektimin e objektivave, niveleve dhe kërkesave të përcaktuara për secilin kualifikim. Planifikimi i orëve të mësimit teorik dhe realizimi i moduleve të praktikës profesionale mbështeten në skeletkurrikulat përkatëse të miratuara nga AKAFPK, ndërsa strukturat e brendshme profesionale, si ekipet lëndore dhe departamentet mësimore, luajnë një rol të rëndësishëm në organizimin, zbatimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të procesit mësimor.

Në kuadër të zbatimit të kurrikulës, IoAFP-të zhvillojnë gjithashtu projekte kurrikulare dhe ndërkurrikulare, të cilat kontribuojnë në zgjerimin e përvojës së të nxënit, zhvillimin e kompetencave sociale dhe profesionale, si dhe në lidhjen e përmbajtjeve mësimore me situata reale.

Analiza e kësaj fushe synon të evidentojë nivelin e zbatimit të kurrikulës, efektivitetin e mbështetjes institucionale për mësimdhënien, funksionimin e strukturave profesionale dhe zhvillimin e mekanizmave që mundësojnë njohjen e kompetencave të fituara përmes të nxënit joformal dhe informal.

Fusha 3 përbëhet nga 5 nënfushat si më poshtë:

3.1 Kurrikula në bazë shkolle

3.2 Kurrikula në Bazë Ofruesi të Formimit Profesional
3.3 Mbështetja për zbatimin e kurrikulës
3.4 Ekipi lëndor dhe departamenti mësimor në IoAFP
3.5 Zbatimi i metodologjisë së validimit të të nxënit të mëparshëm joformal dhe informal

3.1 Kurrikula në bazë shkolle

a. Pikat e forta

- Analiza e raporteve të vetëvlerësimit tregon se IoAFP-të hartojnë dhe zbatojnë kurrikulën me bazë shkolle në përputhje me standardet kombëtare të kualifikimeve profesionale dhe kërkesat e përcaktuara në dokumentet kurrikulare.
- Planet mësimore për komponentin teorik dhe praktik hartohen mbi bazën e skeletkurrikulave të miratuara nga AKAFPK, duke siguruar respektimin e strukturës, objektivave dhe rezultateve të të nxënit për secilin kualifikim profesional.
- Procesi i planifikimit, miratimit dhe zbatimit të veprimtarisë mësimore është i strukturuar dhe i dokumentuar, duke garantuar organizim të qëndrueshëm të procesit kurrikular.
- Në zbatimin e kurrikulës ruhet përputhshmëria me objektivat, nivelet dhe kërkesat specifike të kualifikimeve profesionale, duke mbështetur zhvillimin e kompetencave të përcaktuara për nxënësit.

b. Asektet që kërkojnë përmirësim

- Nga analiza evidentohet nevoja për një përshtatje më të madhe të kurrikulave me bazë shkolle me mundësitë reale të zhvillimit të praktikës profesionale në mjediset e bizneseve partnere. Një planifikim më i koordinuar ndërmjet institucionit dhe biznesit do të mundësonte një lidhje më të drejtpërdrejtë ndërmjet përmbajtjeve kurrikulare dhe situatave reale të punës.
- Në disa raste dokumentimi i projekteve ndërkurrikulare nuk është i plotë, veçanërisht në lidhje me evidentimin e objektivave, rezultateve të arritura dhe përfshirjen e dimensioneve të barazisë gjinore dhe gjithëpërfshirjes. Nevojitet forcimi i praktikave të dokumentimit dhe përdorimi i këtyre përvojave si burim për përmirësimin e procesit mësimor.

3.2 Kurrikula në Bazë Ofruesi të Formimit Profesional

a. Pikat e forta

- Analiza e raporteve të vetëvlerësimit tregon se programet e kurseve të formimit profesional hartohen dhe zbatohen në përputhje me dokumentet zyrtare të miratuara dhe me kërkesat e identifikuara të tregut të punës.

- Ofruesit e formimit profesional dëshmojnë një nivel të mirë të zbatimit të kurrikulës, ku rezultatet e vetëvlerësimit janë vlerësuar kryesisht në nivelet "shumë mirë" dhe "mirë", duke reflektuar përputhshmëri me kërkesat e përcaktuara për organizimin dhe zhvillimin e kurseve profesionale.
- Procesi i zbatimit të kurrikulës mbështetet në dokumentacionin përkatës dhe në organizimin e planifikuar të veprimtarive të formimit, duke kontribuar në realizimin e objektivave të kurseve dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të kursantëve.

b. **Aspektet që kërkojnë përmirësim**

- Nga analiza e raporteve të vetëvlerësimit nuk janë evidentuar problematika të rëndësishme në këtë nënfushë. Megjithatë, mbetet e nevojshme që ofruesit të vijojnë procesin e monitorimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të kurrikulës, në mënyrë që ajo të mbetet e përshtatur me zhvillimet teknologjike dhe ndryshimet në kërkesat e tregut të punës.

3.3 Mbështetja për zbatimin e kurrikulës

a. **Pikat e forta**

- Analiza e raporteve të vetëvlerësimit tregon se IoAFP-të përdorin materiale mësimore mbështetëse të siguruara nga AKAFPK, nga platforma MësoVET.al, si dhe materiale të përgatitura nga vetë mësimdhënësit për lëndët e kulturës profesionale, duke kontribuar në mbështetjen e procesit të mësimdhënies dhe të nxënit.
- Në përgjithësi, institucionet disponojnë mjedise të specializuara dhe pajisje për zhvillimin e praktikës profesionale, duke krijuar kushte për realizimin e komponentit praktik të kualifikimeve profesionale.
- IoAFP-të kanë marrë masa për garantimin e sigurisë gjatë zhvillimit të aktiviteteve praktike, duke respektuar kërkesat për mbrojtjen dhe mirëqenien e nxënësve gjatë procesit të formimit.
- Mësimdhënësit përfshihen në procesin e përzgjedhjes së teksteve dhe materialeve mësimore, duke mundësuar përshtatjen më të mirë të burimeve didaktike me nevojat e procesit mësimor dhe karakteristikat e kualifikimeve profesionale.

b. **Aspektet që kërkojnë përmirësim**

- Nga analiza evidentohet pamjaftueshmëria e teksteve dhe/apo materialeve mësimore për disa kualifikime, ç`ka kufizon mbështetjen e nxënësve dhe mësimdhënësve në procesin e të nxënit dhe kërkon zhvillimin e mëtejshëm të burimeve didaktike të përshtatura me AFP-në.
- Në disa IoAFP mungojnë ose janë të pamjaftueshme laboratorët, pajisjet dhe baza materiale e nevojshme për realizimin cilësor të praktikës profesionale. Kjo paraqet

nevojën për investime të mëtejshme dhe planifikim më të mirë të burimeve, në mënyrë që kushtet e formimit të jenë sa më afër kërkesave të mjedisit real të punës.

3.4 Ekipi lëndor dhe departamenti mësimor në IoAFP

a. Pikat e forta

- Analiza e raporteve të vetëvlerësimit tregon se IoAFP-të kanë ngritur dhe funksionalizuar ekipet lëndore dhe departamentet mësimore në përputhje me kërkesat ligjore dhe strukturën organizative të përcaktuar për institucionet e AFP-së.
- Programet e mësimdhënies për lëndët teorike dhe modulet praktike hartohen, shqyrtohen dhe miratohen përmes proceseve të organizuara, duke siguruar koherencë në zbatimin e kurrikulës dhe realizimin e objektivave të të nxënit.
- Ekipet lëndore dhe departamentet mësimore hartojnë plane vjetore pune të harmonizuara me planin vjetor institucional, duke kontribuar në koordinimin e veprimtarive mësimore dhe në realizimin e objektivave të institucionit.

b. Aspektet që kërkojnë përmirësim

- Nga analiza e raporteve të vetëvlerësimit nuk janë evidentuar problematika të rëndësishme në këtë nënfushë. Megjithatë, vijimi i funksionimit aktiv të ekipeve lëndore dhe departamenteve mësimore mbetet i rëndësishëm për shkëmbimin e praktikave të mira, reflektimin mbi rezultatet e nxënësve dhe përmirësimin e vazhdueshëm të zbatimit të kurrikulës.

3.5 Zbatimi i metodologjisë së validimit të të nxënit të mëparshëm joformal dhe informal

"Pa vlerësim" (Not applicable)

Kjo nënfushë nuk është aplikuar gjatë periudhës së vlerësimit në IoAFP-të e përfshira në procesin e vetëvlerësimit. Për rrjedhojë, nuk janë mbledhur të dhëna dhe evidenca për zbatimin e metodologjisë së validimit të të nxënit të mëparshëm joformal dhe informal dhe kjo nënfushë nuk ndikon në rezultatin e përgjithshëm të vlerësimit të Fushës 3.

Vlerësim i përgjithshëm për Fushën 3

Nga analiza e të dhënave të raporteve të vetëvlerësimit rezulton se Fusha 3 – "Kurrikula e Zbatuar" paraqet një nivel të mirë të zbatimit të kërkesave kurrikulare në shumicën e IoAFP-ve. Institucionet hartojnë dhe zbatojnë kurrikulat dhe programet mësimore në përputhje me standardet kombëtare të kualifikimeve profesionale dhe dokumentet e miratuara, duke siguruar orientimin e procesit mësimor drejt zhvillimit të kompetencave profesionale dhe kyçe të nxënësve.

Procesi i planifikimit dhe organizimit të mësimdhënies teorike dhe praktike rezulton i strukturuar dhe i dokumentuar, ndërsa ekipet lëndore dhe departamentet mësimore luajnë një rol të rëndësishëm në mbështetjen e zbatimit të kurrikulës. Në përgjithësi, IoAFP-të disponojnë mjedise, pajisje dhe burime mbështetëse për realizimin e procesit mësimor, megjithëse niveli i tyre ndryshon ndërmjet institucioneve dhe kualifikimeve profesionale.
Megjithatë, analiza evidenton disa drejtime ku kërkohet përmirësim i mëtejshëm. Nevojitet forcimi i sigurimit të teksteve dhe materialeve mësimore mbështetëse, si dhe një përshtatje më e madhe e kurrikulave me bazë shkolle me kërkesat konkrete të bizneseve partnere dhe zhvillimet e tregut të punës. Gjithashtu, kërkohet përmirësim në dokumentimin e projekteve ndërkurrikulare, duke përfshirë në mënyrë më të qartë dimensionet e barazisë gjinore dhe gjithëpërfshirjes.
Në tërësi, Fusha 3 tregon se IoAFP-të kanë kapacitete të konsoliduara për zbatimin e kurrikulës së miratuar, ndërsa sfida kryesore mbetet rritja e fleksibilitetit dhe lidhjes së saj me mjedisin real profesional, për të siguruar një formim sa më të përshtatur me nevojat e nxënësve dhe të tregut të punës.

Në formë grafike rezultati i fushës për ofruesit e AFP-së do të paraqitej si më poshtë.



FUSHA 4 –MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT

Fusha 4 – "Mësimdhënia dhe të nxënit" fokusohet në cilësinë e procesit mësimor dhe në mënyrën se si IoAFP-të organizojnë dhe zhvillojnë veprimtaritë mësimore për të garantuar përvetësimin e njohurive, shprehive dhe kompetencave kyçe e profesionale nga nxënësit/kursantët.
Kjo fushë vlerëson planifikimin e procesit mësimor, zbatimin e metodave dhe parimeve bashkëkohore të mësimdhënies, mbështetjen e individëve në procesin e të nxënit, si dhe krijimin e një mjedisi të sigurt, gjithëpërfshirës dhe mbështetës për zhvillimin e kompetencave profesionale në përputhje me standardet e profesioneve dhe kualifikimeve profesionale.
Procesi i mësimdhënies në IoAFP mbështetet në planifikime të strukturuara, në përdorimin e metodave aktive të të nxënit dhe në ndërveprimin ndërmjet mësimdhënësve dhe nxënësve/kursantëve. Cilësia e këtij procesi ndikohet nga aftësitë profesionale dhe pedagogjike të stafit, përdorimi efektiv i burimeve mësimore, si dhe nga krijimi i kushteve të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarive teorike dhe praktike.
Në kuadër të kësaj fushe analizohet gjithashtu mbështetja e kandidatëve që përfshihen në proceset e validimit të të nxënit të mëparshëm joformal dhe informal, si dhe masat e ndërmarra nga institucionet për garantimin e një mjedisi të sigurt fizik, emocional dhe profesional për të nxënit.

Fusha 4 përbëhet nga 4 nënfushat në vijim:

4.1 Plani ditor
4.2 Parimet kryesore gjatë orës mësimore
4.3 Mbështetja e kandidatëve të validimit të të nxënit joformal dhe informal
4.4 Mjedisi i sigurt për të nxënët

4.1 Plani ditor

a. Pikat e forta

- Analiza e raporteve të vetëvlerësimit tregon se mësimdhënësit dhe instruktorët planifikojnë në mënyrë të strukturuar procesin mësimor, duke përcaktuar mjetet, materialet didaktike dhe burimet e nevojshme për realizimin efektiv të orëve teorike dhe praktike profesionale.
- Planet ditore të mësimit hartohen në përputhje me programet e mësimdhënies teorike dhe moduleve të praktikës profesionale, duke siguruar lidhjen ndërmjet objektivave të kurrikulës dhe veprimtarive të zhvilluara në klasë apo në mjediset praktike.
- Planet mësimore përfshijnë elementet kryesore të planifikimit pedagogjik, si rezultatet e të nxënit, veprimtaritë mësimore, mënyrat e vlerësimit, detyrat dhe reflektimin mbi procesin e të nxënit.
- Gjatë hartimit të planeve ditore, mësimdhënësit planifikojnë shpërndarjen e kohës për fazat kryesore të orës mësimore, duke përfshirë prezantimin e njohurive të reja,

aktivizimin e njohurive të mëparshme, praktikimin, reflektimin, vlerësimin dhe detyrat për punë të pavarur.

b. Aspektet që kërkojnë përmirësim

- Nga analiza evidentohet nevoja për një integrim më të qëndrueshëm të aftësive të buta, aftësive të gjelbra dhe kompetencave digjitale në planet ditore, me qëllim që këto kompetenca të zhvillohen në mënyrë të planifikuar gjatë procesit mësimor.
- Në disa raste planet ditore nuk reflektojnë në mënyrë të plotë aspektet e barazisë gjinore dhe gjithëpërfshirjes. Nevojitet që këto dimensione të përfshihen më qartë në përzgjedhjen e metodave, materialeve dhe veprimtarive mësimore.
- Planet ditore duhet të parashikojnë më sistematikisht veprimtari të diferencuara dhe detyra të përshtatura për nxënësit me aftësi të kufizuara, duke garantuar mundësi të barabarta për pjesëmarrje dhe arritje të rezultateve të të nxënit.
- Detyrat e shtëpisë dhe aktivitetet e punës së pavarur kanë nevojë të lidhen më shumë me situata konkrete nga jeta reale dhe me kontekste të botës së punës, në mënyrë që të forcohet lidhja ndërmjet njohurive teorike dhe zbatimit praktik të kompetencave profesionale.

4.2 Parimet kryesore gjatë orës mësimore

a. Pikat e forta

- Analiza e raporteve të vetëvlerësimit tregon se mësimdhënësit dhe instruktorët zbatojnë parimin e trajtimit të barabartë të nxënësve dhe kursantëve gjatë organizimit të veprimtarive, detyrave dhe ndërveprimeve në procesin mësimor.
- Procesi i mësimdhënies mbështetet në lidhjen e njohurive të reja me njohuritë dhe përvojat e mëparshme të nxënësve/kursantëve, si brenda të njëjtës lëndë, ashtu edhe përmes integrimit ndërmjet lëndëve dhe moduleve të ndryshme profesionale.
- Nxënësit dhe kursantët përfshihen në veprimtari mësimore dhe situata të të nxënit të përshtatura me nivelin e tyre të përgatitjes dhe nevojat individuale, duke nxitur pjesëmarrjen aktive dhe zhvillimin e kompetencave profesionale.

b. Aspektet që kërkojnë përmirësim

- Nga analiza evidentohet nevoja për zgjerimin e përdorimit të metodave bashkëkohore të mësimdhënies, si dhe për një integrim më të madh të teknologjisë digjitale në procesin e mësimdhënies dhe të nxënit.
- Nevojitet forcimi i qasjeve aktive dhe praktike të të nxënit, përmes përdorimit më të gjerë të metodave si puna në grup, zgjidhja e problemeve, projektet praktike dhe situatat e simuluara profesionale, me qëllim rritjen e angazhimit të nxënësve dhe lidhjen më të mirë me kërkesat e botës së punës.

4.3 Mbështetja e kandidatëve të validimit të të nxënit joformal dhe informal

"Pa vlerësim" (Not applicable)

Kjo nënfushë nuk është aplikuar gjatë periudhës së vlerësimit në IoAFP-të e përfshira në procesin e vetëvlerësimit. Për rrjedhojë, nuk janë mbledhur të dhëna dhe evidenca lidhur me mbështetjen e kandidatëve që përfshihen në proceset e validimit të të nxënit të mëparshëm joformal dhe informal.

Kjo nënfushë nuk ndikon në rezultatin e përgjithshëm të procesit të vetëvlerësimit për Fushën 4.

4.4 Mjedisi i sigurt për të nxënët

a. Pikat e forta

- Analiza e raporteve të vetëvlerësimit tregon se mjediset fizike të klasave, laboratorëve dhe ambienteve të praktikës profesionale janë përgjithësisht të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor dhe realizimin e veprimtarive teorike e praktike.
- Organizimi i hapësirave mësimore krijon mundësi për zhvillimin e punës në grupe të vogla, duke nxitur bashkëpunimin, komunikimin dhe ndërveprimin ndërmjet nxënësve dhe kursantëve.
- Mjediset e të nxënit janë të organizuara në mënyrë që të mundësojnë komunikim të lirshëm, lëvizje dhe përfshirje aktive gjatë zhvillimit të aktiviteteve mësimore.
- Ekspozimi i punimeve individuale dhe në grup në ambiente të dukshme të institucionit kontribuon në rritjen e motivimit të nxënësve, vlerësimin e arritjeve të tyre dhe forcimin e ndjenjës së përkatësisë ndaj institucionit.

b. Aspektet që kërkojnë përmirësim

- Nga analiza evidentohet nevoja për forcimin e bashkëpunimit ndërmjet psikologut, punonjësit social, mësuesve dhe prindërve për identifikimin dhe adresimin në mënyrë më të koordinuar të nevojave sociale dhe emocionale të nxënësve.
- Nevojitet një qasje më e strukturuar për ndjekjen e rasteve që kërkojnë mbështetje të veçantë, përmes komunikimit të rregullt ndërmjet aktorëve përgjegjës dhe dokumentimit të masave të ndërmarra.

Vlerësim i përgjithshëm për Fushën 4

Nga analiza e të dhënave të raporteve të vetëvlerësimit rezulton se Fusha 4 – "Mësimdhënia dhe të nxënit" paraqet një nivel të mirë dhe të konsoliduar zbatimi në IoAFP-të e vlerësuara. Procesi mësimor zhvillohet në një mjedis të organizuar dhe mbështetës, ku mësimdhënësit dhe

instruktorët planifikojnë në mënyrë të strukturuar veprimtaritë mësimore dhe zbatojnë programe teorike e praktike në përputhje me kërkesat e kurrikulës profesionale.
Analiza tregon se gjatë procesit mësimor përdoren qasje që synojnë lidhjen ndërmjet njohurive teorike dhe praktikës profesionale, si dhe nxitet përfshirja aktive e nxënësve dhe kursantëve në veprimtari të ndryshme të të nxënit. Gjithashtu, mjediset mësimore dhe praktike vlerësohen përgjithësisht të përshtatshme për zhvillimin e procesit të formimit profesional dhe krijimin e kushteve të sigurta për të nxënët.
Megjithatë, evidentohen disa drejtime për përmirësim të mëtejshëm, që lidhen me rritjen e përdorimit të metodave bashkëkohore të mësimdhënies dhe teknologjisë digjitale, integrimin më të qëndrueshëm të aftësive të buta, aftësive të gjelbra dhe kompetencave digjitale në procesin mësimor, si dhe forcimin e praktikave gjithëpërfshirëse në planifikimin dhe zhvillimin e orëve mësimore.

Gjithashtu, nevojitet forcimi i bashkëpunimit ndërmjet psikologut, punonjësit social, mësuesve dhe prindërve për identifikimin dhe adresimin më efektiv të nevojave sociale dhe emocionale të nxënësve, duke kontribuar në krijimin e një mjedisi sa më mbështetës dhe gjithëpërfshirës për të nxënët.

Në tërësi, Fusha 4 tregon se IoAFP-të kanë krijuar praktika të qëndrueshme në organizimin dhe zhvillimin e procesit mësimor, ndërsa sfida kryesore mbetet orientimi i mëtejshëm drejt një mësimdhënieje më aktive, digjitale dhe të individualizuar, në funksion të zhvillimit të plotë të kompetencave profesionale dhe personale të nxënësve/kursantëve.

Në formë grafike rezultati i fushës për ofruesit e AFP-së do të paraqitej si më poshtë.



FUSHA 5 - VLERËSIMI

Fusha 5 – Vlerësimi fokusohet në mënyrën se si IoAFP-të planifikojnë, organizojnë dhe zbatojnë proceset e vlerësimit të nxënësve/kursantëve, me qëllim matjen e nivelit të arritjes së rezultateve të të nxënit dhe zhvillimit të kompetencave profesionale e kyçe.

